



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 248/8 Prot

Tiranë më 16.06. 2015

V E N D I M

Nr 57 Datë 16/06/2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e
Këshillit të Qarkut Vlorë**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar), nenet 14 gërma "b", 32, 33, të Rregullores "Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit" të miratuar me Vendimin nr. 17 dt.11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (më poshtë, rregullores), si dhe neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", pas shqyrtimit të materialit, observacioneve dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procesin e inspektimit të përgjithshëm, zhvilluar në institucionin e Këshillit të Qarkut Vlorë,

VËREJ:

Në zbatim të Vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nr. 24, datë 12.03.2015, "*Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Vlorë*", nga ana e grupit të punës, me shkresën nr. 248/1 prot., datë 12.03.2015 "*Njoftim për fillimin e e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Vlorë*" të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në nenin 21 të rregullores, është vendosur komunikimi me institucionin e Këshillit të Qarkut Vlorë, duke kërkuar vënien në dispozicion të materialit të nevojshëm dokumentar për realizimin në kohë e me cilësi të objektit të inspektimit.

Objekti i inspektimit kanë qënë të gjitha institutet e ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar), dhe mënyra e administrimit të shërbimit civil në të gjitha aspektet. Këtu mund të përmendim mënyrën e pranimi në shërbimin civil, lëvizja paralele, ngritja/ulja në detyrë, transferimi apo lirimi nga shërbimi civil i punonjësve në kushtet e ristrukturimit; përshtatshmëria e përshkrimeve të pozicioneve të punës dhe e kërkesave të përgjithshme e të posaçme të tyre me cilësitë individuale të punonjësve të mbajtur në punë pas ristrukturimit, vlerësimet e punës, si dhe nëse ishin mbajtur parasysh dhe respektuar kërkesat e nenit 50 dhe 67 të Ligjit 152/2013

“Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me Ligjin 178/2014 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”*, si dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”* të Këshillit të Ministrave, Kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*.

Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë procesit të inspektimit, rezultoi se subjekti i inspektimit, Këshilli i Qarkut Vlorë, aktualisht funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me vendimin nr.41, datë 17.12.2014 *“Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë”*, ndërsa në momentin e fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, datë 26.02.2014, institucioni funksiononte sipas strukturës organizative të miratuar me vendimin nr. 3, datë 04.02.2014 *“Për miratimin e strukturës të Administratës së Qarkut Vlorë, për vitin 2014”*.

Pas verifikimit të dokumentacionit të administruar, rezultoi se Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklaramit të statusit, ka vepruar drejt, duke nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për 23 punonjës, të cilët kanë qenë më tepër se një vit në pozicion pune pjesë e shërbimit civil, si dhe deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës në periudhë prove për atë kategori punonjësish, të cilët nuk i kanë përmbushur përcaktimet e nenit 67 pika 3, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Rezulton gjithashtu, se institucioni, pas fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* të ndryshuar, ka zhvilluar edhe dy procedura konkurimi për plotësimin e vendeve vakant. Në tërësi, procedurat e këtyre konkurrenive janë kryer në përputhje me nenin 25 dhe 26 të ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* të ndryshuar, si dhe me Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014 *“Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*, të Këshillit të Ministrave, Kreut VII *“Ngritja në detyrë”*. Por, nga ana tjetër, në këto konkurrenive janë konstatuar dhe disa parregullsi të cilat mund ti përmendim si më poshtë: gjatë zhvillimit të procedurës së konkurimit nuk është respektuar pika 5 e VKM nr.143, datë 12.03.2014 *“Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*, që parashikon detyrimin e njesisë së qeverisjes vendore të bëjë shpalljen në portalin *“Shërbimi Kombëtar i Punësimit”*, por është mjaftuar me shpalljen e pozicionit të lirë në portalin e Departamentit të Administratës Publike dhe në vendin e shpalljeve publike të institucionit. Mosrespektimi i procedurës së mësipërme ka sjellë mosrespektimin e afateve të përcaktuara në pikën 7 dhe 9 të vendimit të mësipërm.

Aktet e emërimit të kandidatëve fitues janë nxjerrë nga njësi përgjegjëse, jo sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.143, datë 12.03.2014 *“Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*, pikës 9 dhe 10, KREU VII *“Ngritja në Detyrë”*. Kandidatëve fitues nuk u është marrë miratimi zyrtar i pranimit të pozicionit të punës dhe nuk është bërë shpallja e tyre në portalin *“Shërbimi Kombëtar i Punësimit”*.

Nisur nga fakti se ekzistenca e këtyre parregullsive nuk cënon thelbin e procesit të pranimit në shërbimin civil, pasi realizohet qëllimi i transparencës së konkurimit, këto janë përmëndur në material për të shërbyer për përmirësimin e punës në të ardhmen.

Nga ana tjetër, konstatohet që për shkak të pakësimit të fondit në buxhetin e institucionit, prej 15% të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ, në zbatim të nenit 15 të Ligjit 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015, Këshilli i Qarkut Vlorë ka kaluar një proces të plotë ristrukturimi.

Sipas strukturës së miratuar me Vendimin nr. 03, datë 04.02.2014 “Për miratimin e Strukturës të Administratës së Qarkut Vlorë, për vitin 2014” të Këshillit të Qarkut Vlorë, (pra, para fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar), numri i përgjithshëm i punonjësve të institucionit ishte 44 punonjës, nga të cilët 29 pozicione përfshiheshin në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Me miratimin e strukturës së re me Vendimin nr. 41, datë 17.12.2014 “Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë”, që është aktualisht në fuqi, administrata e Këshillit të Qarkut Vlorë përbëhet vetëm prej 14 pozicione pune, nga të cilët 8 pozicione pune në shërbimin civil.

Pas miratimit të strukturës së re, me Urdhërin nr. 1, datë 26.12.2014 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të Mbylljes apo Ristrukturimit”, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit duke respektuar kërkesat e nenit 50 e vijues të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.171, dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave. Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në kompetencat e parashikuara në ligj, ka ushtruar funksionin e tij për zbatimin e procedurave ligjore për lirimin e nëpunësve nga shërbimi civil, pozicionet e punës të të cilëve, ishin shkurtuar apo riorganizuar.

Aktet e lirimit të nxjerra nga njësia përgjegjëse, konstatohet se kanë dalë në përputhje me kërkesat e nenit 50 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin nr.171 datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, duke zgjidhur në të njëjtën kohë edhe problemin e masës së dëmshpërblimit të nëpunësve të cilët lirohen nga shërbimi civil për shkak ristrukturimi. Në raportin përfundimtar është ndërhyrë edhe për rregullimin e disa pasaktësive në llogaritjen e masës së dëmshpërblimit, duke përcaktuar pozicionin dhe pagën e saktë mbi të cilën duhen bërë këto llogaritje.

Vlerësohen të drejta kriteret e mbajtura parasysh nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të emërimit për ata punonjës që janë mbajtur në punë pas ristrukturimit. Nisur nga shkurtimi i pozicioneve të punës si pasojë e ristrukturimit dhe nga fakti që pas kësaj realizimi i funksioneve dhe plotësimi i misionit të institucionit do të kryhet nga një numër më i vogël punonjësish, me të drejtë është preferuar mbajtja në punë e nëpunësve me kualifikim dhe eksperiencë më të lartë. Megjithatë, konstatohet se në ato raste kur janë bërë emërimet pas ripozicionimit në bazë të strukturës së re, qoftë në nivele paralele apo në pozicione të një niveli më të ulët, nuk është marrë pëlqimi i nëpunësit, detyrim ky që rrjedh nga

neni 50, i ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe pika 20, kreu III, i VKM nr. 171 dt. 26.3.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil."

Gjithsesi, këto parregullsi nuk çenojnë në përmbajtje procesin e ristrukturimit, prandaj në raport janë lënë detyrat përkatëse, për përmirësimin e gjëndjes.

Në përfundim të procesit të inspektimit, grupi i inspektimit ka hartuar projektraportin dhe e ka dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 248/4, datë 18.05.2015 "Dërgohet projektraporti i inspektimit", duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin. Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, me shkresën e rregjistruar pranë Komisionerit, me nr. 924/1, datë 21.05.2015 "Konfirmim projektraporti". Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse, rezulton se subjekti i inspektuar është shprehur dakort me konkluzionet e arritura nga grupi i punës dhe nuk ka bërë asnjë vërejtje në lidhje me materialin.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar. Në këto rrethana, Komisioneri vijoi me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të inspektimit, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerëson se duhet të miratojë përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, si dhe nenet 32, 33, të Rregullores "Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit" miratuar me vendimin nr. 17 dt. 11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Këshilli i Qarkut Vlorë, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë të revokojë aktin e emërimit nr. 6, 7 dhe 8, datë 29.01.2015 që i përket punonjësve: ***** me detyrë Kryeinspektor i Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Urbanistikës; ***** me detyrë inspektor në Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Urbanistikës dhe ***** me detyrë inspektor në Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Urbanistikës të Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Njësia përgjegjëse të fillojë procedurat e konkurimit për pozicionin e Kryeinspektorit dhe të 2(dy) inspektorëve të Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Urbanistikës, sipas përcaktimeve të nenit 22 të Ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" të ndryshuar dhe Vendimit nr.243, datë 18.03.2015 "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese", të Këshillit të Ministrave.
4. Të rillogaritet dëmshpërblimi financiar për nëpunësin ***** dhe nëpunësin ***** në përputhje me vjetërsinë në punë, sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 50, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 171,

datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave: për ***** , në pozicionin “specialist” në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit në Këshillin e Qarkut Vlorë dhe për punonjësin ***** në pozicionin “specialist” në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Infrastrukturës në Këshillin e Qarkut Vlorë.

5. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të riemëruar pas rristrukturimit, sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe rristrukturimit të institucionit” të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe të administrojë atë në dosjen e personelit (dosje individuale).
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja në dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
7. Me kalimin e këtij afati , subjekti i inspektuar , Këshilli i Qarkut Vlorë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
8. Për këtë vendim të njoftohet Këshilli i Qarkut Vlorë dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke u dërguar nga një kopje të raportit përfundimtar të inspektimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA